



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA**

**QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**

**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU, TEHNOLOGIJU I INOVACIJU  
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY& INNOVATION**

Datë: 22.10.2021

Prishtinë

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit shpall:

## **KONKURS**

Për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme të larta për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për vitin shkollor 2021/2022

### **1. Kushtet e përgjithshme për ndarjen e bursave:**

Bursat ndahen për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të regjistruar në klasën e 10-të, 11-të, 12-të, të arsimit të mesëm të lartë, gjimnaze dhe shkolla profesionale në Republikën e Kosovës, për vitin shkollor 2021/2022.

### **2. Qëllimi i projektit të bursave:**

Qëllimi i projektit për ndarjen e bursave është ofrimi i mbështetjes financiare për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit mbështet politika dhe programe të cilat sigurojnë arsimim kualitativ edhe për nxënësit e komuniteteve.

Objektivat kryesore të projektit janë:

- a. Përfshirja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë në shkollat publike të Republikës së Kosovës;
- b. Sigurimi i iniciativave, përfshirë ndarjen e bursave për të reduktuar braktisjen e mësimit tek nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;

- c. Rritja e numrit të nxënësve të cilët do të ndjekin arsimin e mesëm të lartë, përmes mbështetjes financiare me bursa;
- d. Ngritja e suksesit të nxënësve duke iu ofruar mbështetje financiare.

### 3. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- a. Vërtetimi nga shkolla se nxënësi është në njërin nga klasat e shkollës së mesme të lartë në shkollat publike të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 2021/2022;
- b. Dëftesa origjinale për shikim dhe kopja e të njëjtës për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) - arsimit të obligueshëm, ose dëftesa mbi përfundimin e vitit paraprak të shkollës së mesme të lartë;
- c. Aplikacioni i plotësuar, të cilin mund ta shkarkoni në web faqen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)  
<http://masht.rks-gov.net/publikimet>;
- d. Për raste sociale – Vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale i cili vërteton se familja merr ndihmë sociale dhe Vërtetimi nga Qendra për Punësim për statusin e punësimit për të dy prindërit (1, apo kujdestarin) që të dy prindërit janë të papunë;
- e. Në rast se prindi është në marrëdhënie pune preferohet të silllet kontrata e punës;
- f. Për fëmijët jetimë – të dorëzohet vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale;
- g. Ekstrakti i lindjes dhe në rast të posedimit të letërnjoftimit apo pasaportës të silllet kopja e dokumentit;
- h. Vetëdeklarimi për përkatësinë etnike nga aplikuesi;
- i. Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës (personale dhe/apo e prindit);
- j. Të gjithë që posedojnë llogari bankare valide të sjellin kopjen e llogarisë personale apo të prindit.

**Vërejtje:**

**Llogarija bankare duhet te jete rrjedhese dhe jo e kursimeve apo e pensionisteve**

### 4. Kriteret për ndarjen e bursave:

Përzgjedhja e fituesve të bursave do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në vijim:

- a) Sukses i bazuar në notë mesatare nga shkolla/klasa paraprake;
- b) Vërtetimi për gjendjen socio – ekonomike të nxënësit (punësimin e prindit, statusin familjar dhe jetesën) – vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale;
- c) Vendbanimi (distanca shkollë – shtëpi);
- d) Gjinia e nxënësit (kandidatët femra kanë përparësi në përzgjedhje);
- e) Mungesa e përkujdesit prindëror (sipas dëshmisë).

Kandidatët rangohen sipas numrit të tërësishëm të pikëve të fituara nga kriteret e përcaktuara me këtë konkurs.

### 5. Afati i aplikimit dhe përzgjedhja e përfituesve:

Afati për aplikim fillon më 22.10.2021 dhe mbaron më 05.11.2021

Aplikimi pas përfundimit të afatit të lartshënuar si dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

E drejta e ankesës do të mund të bëhet brenda tri ditëve, nga dita e shpalljes së listës së përfituesve. Rezultatet do të shpallen më së largu deri më 30 nëntor 2021 në ueb faqen e MASHTI-it <http://masht.rks-gov.net/publikimet>.

#### **6. Lartësia dhe numri i bursave:**

Lartësia e bursave është 30 euro në muaj, apo 300 euro për një vit mësimor.

Numri i bursave do të përcaktohet në bazë të mjeteve të cilat janë në dispozicion për vitin shkollor 2021/2022.

Pagesa e bursave bëhet gjatë vitit mësimor, përmes xhirollogarisë, në bazë të kësteve të përcaktuara nga Komisioni i MASHTI, në 1 apo më shumë këste.

#### **7. Mënyra e aplikimit:**

Forma e aplikimit dhe dokumentacioni përcjellës i kërkuar sipas këtij konkursi dorëzohet në MASHT në katin e përdhësë – zyre nr. 4, Rruga: Agim Ramadani, 10 000 Prishtinë.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret për përfitim të bursës, ka afat ankese brenda 3 ditëve, nga koha e shpalljes së rezultateve në web faqen e MASHTI.

Ankesa do t'i paraqitet Komisionit përzgjedhës për ndarjen e bursave (në MASHTI) dhe në raste të jashtëzakonshme edhe komisionit për ankese dhe parashtrësia në MASHTI. Ankesa duhet të jetë e arsyetuar dhe të ketë të bashkëlidhura dokumentet që e argumentojnë ankesën. Përgjigjja në ankesë do të jepet brenda 3 ditësh.

Sipas vendimit të Komisionit përzgjedhës për ndarjen e bursave, MASHTI nxjerr vendim për përfituesit e bursave. Bursa jepet pa obligim për kthim. MASHTI-i, do ta bëjë monitorimin e vijueshmërisë së nxënësve përfitues. Shfrytëzuesit të bursës do t'i ndërpritet bursa në rast se është përfitues i ndonjë burse tjetër, nëse braktis shkollimin, apo ka numër të paarsyeshëm të mungesave në vijueshmëri të mësimit dhe ka rënie të madhe të suksesit. Puna me palë në MASHTI-Prishtinë bëhet çdo ditë pune prej orës 09:00 -12:00 dhe 13:30-15:30. Pranimi i aplikacioneve bëhet në katin e përdhësë, Nr. i zyrës 4 në MASHTI. Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni në adresat në vijim: nr. tel. 044307559 dhe e-mail: [Nazan.Safqi@rks-gov.net](mailto:Nazan.Safqi@rks-gov.net);